



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA SHERBIMEVE PUBLIKE, DHE NDJEKJES SË INVESTIMEVE TË INFRASTRUKTURËS

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2021

Lënda: Përgjigje kërkesës tuaj për informacion.

Të nderuar,

Duke ju përgëzuar mbi misionin që qendra juaj ka në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit, në vijim të kërkesës tuaj për informacion që daton me 22.03.2021 rregjistruar në rregjistrin e protokollit të Bashkisë Shkodër me Nr.4671 Prot datë 23.03.2021, po i përgjigjemi pyetjeve tuaja si më poshtë vijon:

- Segmenti që ju citoni në kërkesë i përket një rruge që lidh dy njësi administrative Njësinë administrative Rrethina dhe njësinë Gur i Zi. Kjo rrugë kalon nga ish-vend grumbullim i mbeturinave për Bashkinë Shkodër e cila ka funksionuar si e tillë deri në Nëntor të vitit 2013. Që mbas këtij viti Bashkia Shkodër depoziton mbeturinat urbane në lëndfillin e Bushatit.
- Ky segment rrugor nuk ka qene asnjehere e asfaltuar. Kjo rrugë nuk ka infrastrukturën e favorshme për të vendosur kontenierë sepse makinat e grumbullimit të mbeturinave e kane të pa mundur të kalojnë këtë segment rrugor për shkak të mungesës të infrastrukturës. Banorët e kësaj zone dorëzojnë mbeturinat urbane në pikën më të afërt, pikë e cila pastrohet tre deri në katër herë në javë në sezonin turistik, sepse i përket zonës funksionale lindore të shërbimit të pastrimit bazuar në Kontratën respektive dhe procedurën standarte të veprimit që Bashkia Shkodër ka në zbatim për monitorimin e shërbimit të pastrimit në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë.
- Segmenti rrugor për të cilën interesoheni është parë me prioritet për të analizuar gjëndjen infrastukurore dhe për të llogaritur koston e investimit për realizimin e rikonstruksionit të plotë të segmentit rrugor. Vlera e Investimit është llogaritur 136.000.000 Lekë, vlerë e cila e kalon mundësinë e mbulimit vetëm nga Buxheti i Bashkisë Shkodër.

Ju faleminderit dhe ju urojmë punë të mbarë.

